

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6999  
E martë, 19 shtator 2023  
Çmimi 0.40 €

Mahmuti: Do të jem  
dëshmitar i mbrojtjes  
në rastin e Pjetër Shalës  
në Hagë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE LIDHUR  
ME TAKIMIN E 14 SHTATORIT NË BRUKSEL | FAQE 3

## KURTI, AKUZA NDAJ LAJÇAKUT: ËSHTË POZICIONUAR KUNDËR KOSOVËS



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për medie nuk ka kursyer akuzat ndaj emisarit evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Duke komentuar takimin e 14 shtatorit

në Bruksel, Kurti ka thënë se Lajçaku është pozicionuar kundër Kosovës. Ai ka thënë se në takimin e Brukselit, Lajçaku dukej se ishte koordinuar me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Kurti ka

thënë se për këto veprime të Lajçakut i ka informuar Uashingtonin, Berlinin, Parisin dhe Romën zyrtare. Por, opozita e ka quajtur Kurtin të paafte për ta drejtuar dialogun

### AKTUALE



KURTI DHE OPOZITA REPLIKOJNË  
NGA DISTANCA PËR ZGJEDHJET E  
REJA | F. 7

KONJUFCA: KOSOVA E PËRKUSHTUAR  
PËR PAQE DHE INTEGRIM  
NË INSTITUCIONET EVROPIANE | F. 5

HARADINAJ: KOSOVA NË NATO  
ËSHTË ZGJIDHJA, JO ANASJELLTAS  
| F. 5

ABDIXHIKU PËRMEND 50 NGA 100  
PREMTIMET E PROGRAMIT "RRUGA  
E RE" | F. 7

### EKONOMI



HOTI: TRENDI RËNËS I EKONOMISË  
PO VAZHDON GJATË GJITHË  
MANDATIT TË KËSAJ QEVERIE | F. 8

ATK-ja NDRYSHON PROCEDURAT E  
PAJISJES ME VËRTETIM TATIMOR  
| F. 8

### SPORT



NJËZËRI: DHUNA NUK  
KA VEND NË SPORT | F. 10

OSMANI NË  
NJU-JORK:  
MËRGATA JONË NË  
SHBA KA QENË  
FORCË SHYTYTËSE E  
SHUMË PROCESHEVE  
HISTORIKE PËR  
KOSOVËN

FAQE 4



NESRETE KUMNOVA  
DORËZON KALLËZIM PENAL  
NDAJ VELJKO ODALLOVIQIT



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Erdogani lobon që Musk të hapë fabrikë të "Teslas" në Turqi

NJU-JORK, 18 SHTATOR - Presidenti turk Rexhep Taip Erdogan i ka bërë thirrje Elon Muskut ta hapë një fabrikë të re të "Teslas" në Turqi, duke u bërë lideri i fundit që lobon kështu te njeriu më i pasur në botë.


Erdogani dhe Musku kanë mbajtur një mori takimesh në Turqi dhe në margjina të forumeve ndërkombëtare, duke e thelluar miqësinë edhe më tepër të dielën në Nju-Jork. Zyra e Erdoganit ka thënë të hënën se ai i ka kërkuar

"Teslas" që ta hapë fabrikën e shtatë në Turqi. Agjencia shtetërore e lajmeve në Turqi, "Anadolu", ka thënë se Musk i ka thënë Erdoganit se shteti i këtij të fundit është ndër "kandidatët më të rëndësishëm" për hapje të fabrikës së re.

Përpjekje të ngjashme me të Erdoganit kanë bërë edhe presidenti francez Emmanuel Macron, i cili e ka takuar Muskun në qershor, si dhe kryeministri spanjoll Pedro Sanchez.

Erdogani është në Nju-Jork për të marrë pjesë në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ai sot (e martë) do të mbajë një fjalim. "Tesla" aktualisht i ka gjashtë fabrika, përfshirë dy jashtë Shteteve të Bashkuara – një në Shangai, të fokusuar në tregun aziatik dhe një tjetër në Berlin, të fokusuar në tregun evropian.

Aktualisht kompania është duke e hapur një fabrikë në Meksikë dhe planifikon të ketë e pranishme edhe në Indi.



## Tajvani i kërkon Kinës "t'i ndalë veprimet e njëanshme shkatërruese"

TAIPEI, 18 SHTATOR - Tajvani i ka kërkuar Kinës t'i ndalë "veprimet e njëanshme shkatërruese" pasi më shumë se 100 avionë luftarakë kinezë dhe nëntë luftanije u detektuan në zonat përreth ishullit vetëqeverisës.

Pekini pretendon se Tajvani është pjesë e territorit të tij të cilin një ditë do ta rimarrë, duke mos përjashtuar mundësinë e përdorimit të forcës. Vitet e fundit Kina ka rritur presionin diplomatik dhe ushtarak ndaj Tajvanit.

Më 18 shtator Ministria tajvaneze e Mbrojtjes ka theksuar se numri i detektuar i avionëve luftarakë në 24 orët e fundit paraqet një rekord të regjistruar së fundi, ndërkaq Pekini ende nuk ka komentuar për këtë situatë.

"Në mes të mëngjesit të 17 dhe 18 shtatorit, Ministria e Mbrojtjes Kombëtare ka detektuar në total 103 avionë luftarakë kinezë, shifër rekorde e kohëve të fundit. Këto fluturake paraqesin sfida të mëdha për sigurinë në mbarë Ngushticën e Tajvanit dhe në rajon. Ngacimi i vazhdueshëm ushtarak i Pekinit shumë lehtë mund të çojë në rritje të tensioneve dhe ta përkeqësojë sigurinë rajonale", tha ministria e cila i bëri thirrje Kinës që "menjëherë të ndalë veprime të tilla të njëanshme shkatërruese",



është thënë në deklaratën e kësaj ministrie.

Nga numri i përgjithshëm i avionëve luftarakë të detektuar, 40 prej tyre kanë kaluar vijën në Ngushticën e Tajvanit që ndan ishullin nga Kina dhe kanë hyrë në pjesën jugperëndimore dhe juglindore të zonës identifikuese të mbrojtjes ajrore të Tajvanit, kanë thënë autoritetet në Taipei.

Javën e kaluar Taipei ka raportuar për një sërë inkursionesh nga avionët luftarakë kinezë dhe anijet. Këto zhvillime kana ardhur në kohën kur Pekini ka thënë se ka vendosur trupat e tij "në gatishmëri të lartë", pasi dy anije që iu përkisnin Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë kaluan përmes Ngushticës së Tajvanit.

Ministria e Mbrojtjes e Tajvanit ka

thënë se 68 avionë luftarakë kinezë dhe 10 anije të marinës kineze u detektuan përreth ishullit të mërkurës dhe të enjten e javës së kaluar. Disa nga këta avionë dhe luftanije ishin nisur drejt një zone të paspecifikuar në Paqësorin Perëndimor "për të kryer stërvitje të përbashkëta detare dhe Ajrore" dhe në mesin e tyre ishte edhe avionmbajtësja kineze "Shandong", ka njoftuar ministria tajvaneze.

"Shandong" - një prej dy avionmbajtësve operacionale të flotës kineze - është dedektuar javën e kaluar rreth 110 kilometra në juglindje të Tajvanit, teksa ishte nisur drejt Paqësorit Perëndimor, kanë thënë autoritetet tajvaneze.

Javën e kaluar Ministria japoneze e Mbrojtjes ka thënë se marina e saj

kishte detektuar gjashtë anije, përfshirë fregata, anije shkatërruese, katër anije mbështetëse luftarake dhe "Shandongun", duke lundruar rreth 650 kilometra në jug të ishullit Mijakojima në lindje të Tajvanit.

Japonia ka konfirmuar se ka detektuar avionë dhe helikopterë duke u nisur dhe duke ateruar në Shandong, edhe pse Kina zyrtarisht nuk ka komentuar për ndonjë stërvitje që po kryen në Paqësor.

Analistët kanë thënë se Kina mund të jetë duke "treguar muskujt" që t'i kundërvihet ndikimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Azi-Paqësor, pasi Uashingtoni ka udhëhequr disa stërvitje ushtarake me aleatët në mbarë rajonin.

"Politikisht, Kina t'i kundërvihet kontrollit ushtarak të aleatëve demokratikë që udhëhiqen nga ShBA-ja", ka thënë për "AFP"-në, Su Tzu-yun, analist në Institutin e Tajvanit për Kërkime të Sigurisë dhe Mbrojtjes Kombëtare.

Pas vizitës së Nancy Pelosit - atëbotë kryetare e Dhomës së Përfaqësuesve - gushtin e kaluar, Kina ka kryer stërvitjet më të mëdha ushtarake përreth Tajvanit. Më pas në prill të këtij viti Pekini ka kryer një stërvitje treditore ushtarake për ta simuluar

rrethimin e ishullit, pasi presidentja tajvaneze, Tsai Ing-wen, është takuar në Kaliforni me kryetarin e Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy.

Përderisa Pekini ende nuk ka lëshuar asnjë deklaratë për ngjarjet e fundit, tabloidi shtetëror kinez "Global Times" ka publikuar një koment në platformën sociale "Weibo". "Tajvani dhe Kina bëjnë pjesë në të njëjtën Kinë dhe Tajvani është pjesë e shenjtë dhe e patjetërsueshme e Kinës.

Aktivitetet trajnuese të Ushtrisë Popullore Çlirimtare janë veprime të nevojshme për ta mbrojtur sovranitetin kombëtar dhe integritetin territorial", ka raportuar "Global Times", duke iu referuar ushtrisë së Kinës.

Kina dhe Tajvani janë ndarë gjatë luftës civile të vitit 1940, por Pekini insiston se ky ishull do t'i kthehet dikur nën kontroll. Tajvani ka Kushtetutën e vet, liderë të zgjedhur në mënyrë demokratike dhe rreth 300 mijë trupa aktive ushtarake. Megjithatë, pavarësia e këtij ishulli vetëqeverisës njihet nga pak shtete. ShBA-ja nuk ka lidhje zyrtare me Tajvanin, por Uashingtoni ka një ligj që parasheh dërgimin e mjeteve që i duhen ishullit për ta mbrojtur veten.

## OKB-ja paralajmëron për rrezik të sëmundjeve në Libinë e përmbytur

NJU-JORK - 18 shtator Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) kanë paralajmëruar se shpërthimi i ndonjë sëmundjeje në Libi mund ta përballë këtë vend me "krizë të dytë shkatërruese", pas një jave të vërshimeve masive të cilat e kanë shkatërruar qytetin bregdetar Derna dhe i kanë lënë mijëra njerëz të vdekur.

Zyrtarët lokalë, agjencitë e ndihmës dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë "janë të shqetësuara për rrezikun e përhapjes së sëmundjeve, kryesisht për shkak të ujit të kontaminuar dhe mungesës së kanalizimeve", kanë thënë

Kombet e Bashkuara. Vërshimet i kanë lënë të vdekur rreth 3 300 persona dhe mijëra të tjerë vazhdojnë jenë të zhdukur prej kur stuhia Daniel ka zbarkuar në këtë shtet më 10 shtator.

Dhjetëra mijëra banorë të traumatizuar tani janë të pastrehë dhe në nevojë të madhe për ujë të pijshëm, ushqime dhe produkte bazike, teksa rriten rreziqet për diarje, dehidrim dhe kequshqyerje, kanë paralajmëruar agjencitë e OKB-së.

Ekipet e shpëtimit nga disa vende evropiane dhe arabe janë në kërkim të trupave nën rrënoja. "Nuk kam marrë asgjë

përveç syzeve dhe telefonit, dhe kam ikur derisa uji merrte gjithçka", ka thënë Abdel Moneim Awad al-Sheikh, 73-vjeçar, i cili është zgjuar nga gjumi në orët e para të mëngjesit nga britmat dhe sasia e ujit.

Ai i ka ikur katastrofës duke u ngjitur bashkë me gruan në çatinë e shtëpisë.

Prej rrëzimit të udhëheqësit Muammar Gaddafi më 2011, Libia është ndarë në mes të dy qeverive rivale, të cilat janë përfshirë disa herë në konflikte.

Kryeministri Abdul Hamid Dbeibah e udhëheq Qeverinë e Unitetit Kombëtar në Tripoli



dhe gëzon mbështetjen e Kombeve të Bashkuara. Osama Hamad, kryeministër

në lindje, udhëheq një administratë rivale e njohur si Shtëpia e Përfaqësuesve.



## Nesrete Kumnova dorëzon kallëzim penal ndaj Veljko Odalloviqit

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Udhëheqësja e shoqatës "Thirrjet e Nënave", Nesrete Kumnova, ka dorëzuar kallëzim penal në Prokurorinë Speciale të Kosovës ndaj Veljko Odalloviqit, i cili gjatë kohës së luftës mbante pozitën e kryetarit të Qarkut të Kosovës. Kumnova në "Facebook" ka shkruar se Odalloviqi dyshohet se është i përfshirë dhe mban përgjegjësi komanduese për kryerjen e veprave penale të

krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Odalloviq, i cili aktualisht mban pozitën e kryetarit të Komisionit të Qeverisë së Serbisë për Personat e Zhdukur, sipas Kumnovës, duhet të japë përgjigje për krimet e kryera nga forcat e Serbisë gjatë luftës në Kosovë. "Veljko Odalloviq, që gjatë luftës në Kosovë ishte kryetar i Qarkut të Kosovës dhe aktualisht mban pozitën e

kryetarit të Komisionit të Qeverisë së Serbisë për Persona të Zhdukur, dyshohet se është i përfshirë dhe mban përgjegjësi komanduese për kryerjen e veprave penale të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Veljko Odalloviq duhet të japë përgjigje për krimet e kryera nga forcat e Serbisë gjatë luftës në Kosovë e jo të mbajë përgjegjësi për zbardhjen e tyre", ka shkruar Kumnova.



## Osmani në Nju-Jork: Mërgata jonë në ShBA ka qenë forcë shtytëse e shumë proceseve historike për Kosovën

NJU-JORK, 18 SHTATOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila është duke qëndruar në Nju-Jork, ku po mbahet sesioni i 78-të i Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), nën organizimin e aktivistit të mërgatës shqiptare dhe shërbimeve filantropike, Mark Gjonaj, ka takuar një grup të organizatave të komunitetit shqiptar nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Presheva, Medvegja, Bujanovci dhe Mali i Zi, të cilat veprojnë në ShBA. Sipas presidentes Osmani, ky takim me mërgatën shqiptare është dëshmi e lidhjeve të forta dhe të qëndrueshme ndërmjet popullit të Kosovës si dhe komunitetit shqiptar në përgjithësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë kontekst, Osmani ka falënderuar komunitetin shqiptar, i cili, përveçse në forcimin e lidhjeve të Kosovës me ShBA-në, e ka ndihmuar shtetin e Kosovës në procesin e lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit. "Ju jeni forca shtytëse e shumë proceseve nëpër të cilat ka kaluar Kosova. Liria dhe shteti ynë janë rezultat edhe i angazhimit të vazhdueshëm të mërgatës sonë këtu, ndaj faleminderit për gjithçka që keni bërë dhe po bëni. Na duhet edhe më tej angazhimi juaj. Kosova ka nevojë për mbështetjen tuaj dhe të ShBA-së. E di që nuk hezitoni, ndaj presim që bashkërisht, pa dallim, të



angazhohemi që ta fuqizojmë shtetin tonë krahas mbështetjes dhe koordinimit me aleatët tanë", ka theksuar Osmani. Më tutje, Osmani ka shtruar nevojën e ruajtjes dhe promovimit të kulturës dhe trashëgimisë sonë në Shtetet e Bashkuara, për të cilën gjithë tha se rol me rëndësi luajnë shoqatat të cilat i grumbullojnë shqiptarët. Në bashkëbisedim me mërgatën, presidentja Osmani ka thënë se Kosova pret mbështetjen e tyre edhe në fushën e investimeve. Sipas presidentes Osmani, në Kosovë tashmë është krijuar një

klime të përshtatshme për investime, ndaj investimet nga mërgata janë të mirëseardhura. Ndërkaq përfaqësues të shoqatave që grumbullojnë shqiptarët në ShBA kanë falënderuar presidenten Osmani për takimin dhe shprehën mbështetjen e palëkundur për Kosovën dhe përkushtimin për të ndihmuar iniciativën të ndryshme, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e shtetit. Në këtë takim Osmani ka qenë e shoqëruar nga ambasadori i Kosovës në ShBA, Ilir Dugolli dhe

konsulli i përgjithshëm i shtetit tonë në Nju-Jork, Blerim Reka. Po ashtu, presidentja në Nju-Jork ka marrë pjesë në një ceremoni në të cilën është shënuar 10-vjetori i grave lidere në politikë. Në një adresim para grave të tjera lidere, Osmani ka folur për angazhimin dhe rolin e shquar të grave në epokë të ndryshme të historisë së zhvillimit të vendit. Ajo ka theksuar se Kosova në 15 vjetet e pavarësisë së saj shquhet për lidhshmëri të grave në politikë, teksa ka potencuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe rrjetëzimit të vazhdueshëm me qëllim të

fuqizimit të grave në jetën publike. Osmani në adresimin e saj ka thënë se Kosova po dëshmohej si vend lider në udhëheqjen e agjendës për gratë, paqen dhe sigurinë dhe ka potencuar se fuqizimi i grave në fushën e sigurisë, si dhe në fusha të tjera, është mundësia më e mirë për ta avancuar shoqërinë në tërësi. Gjatë qëndrimit në Nju-Jork, Osmani është takuar edhe me mbretin e Jordanisë, Abdullahu II, të cilin e ka falënderuar për mbështetjen që është duke i dhënë Kosovës.

## Mahmuti: Do të jem dëshmitar i mbrojtjes në rastin e Pjetër Shalës në Hagë

HAGË, 18 SHTATOR - Ish-përfaqësuesi politik i UÇK-së, Bardhyl Mahmuti, ka njoftuar se me kërkesë të avokatëve të Pjetër Shalës, ka pranuar të jetë dëshmitar i mbrojtjes në Hagë. Ai ka bërë me dije se dëshminë do ta fillojë nesër (e mërkurë). "Me kërkesë të avokatëve të z. Pjetër Shala, kam pranuar të jem

dëshmitar i mbrojtjes në këtë proces gjyqësor. Sot do të udhëtoj për në Hagë, për procedurat paraprake, ndërsa dëshmia ime do të fillojë të mërkurën, më 20 shtator 2023. Ju njoftoj se gjatë qëndrimit tim në Hagë (deri më 23 shtator), do të shmang komunikimin me telefon ose nëpërmjet rrjeteve sociale", ka

shkruar Mahmuti në "Facebook". Në aktakuzën e konfirmuar nga Gjykata Speciale, Pjetër Shala ngarkohet me përgjegjësi penale individuale në formë të ndryshme për, kinse, krime lufte. Ndaj akuzave të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Shala është deklaruar i pafajshëm.







KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE LIDHUR ME TAKIMIN E 14 SHTATORIT NË BRUKSEL

# Kurti, akuza ndaj Lajçakut: Është pozicionuar kundër Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për medie nuk ka kursyer akuzat ndaj emisarit evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Duke komentuar takimin e 14 shtatorit në Bruksel, Kurti ka thënë se Lajçaku është pozicionuar kundër Kosovës. Ai ka thënë se në takimin e Brukselit, Lajçaku dukej se ishte koordinuar me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Kurti ka thënë se për këto veprime të Lajçakut i ka informuar Uashingtonin, Berlinin, Parisin dhe Romën zyrtare. Por, opozita e ka quajtur Kurtin të paaftë për ta drejtuar dialogun

**EPOKA E RE**

**Lirim GEÇI**

**PRISHTINË, 18 SHTATOR** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendësi i tij, Besnik Bislimi, ka mbajtur të hënën një konferencë për medie, në të cilën ka bërë një mal akuza në drejtim të emisarit të Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Kurti, duke komentuar takimin e 14 shtatorit në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, e ka akuzuar Lajçakun se është "pozicionuar" kundër Kosovës. Kurti ka thënë se Lajçaku "pati një pozicionim të qartë të ndërmjetësit kundër

Kosovës në përgjithësi, kundër marrëveshjes (drejt normalizimit të raporteve) në veçanti".

Në këtë kontekst, Kurti ka thënë se dukej se kishte një koordinim në mes të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe Lajçakut për, siç ka theksuar, krijimin e një "skenari alternativ, ku gjysma e marrëveshjes zbatohet". "Ditëve në vijim me siguri që unë do të kem takime me të gjithë faktorët ndërkombëtarë, të cilët kanë pranuar shtetin e Kosovës dhe të cilët dëshirojnë të na ndihmojnë e të na përkrahin sa i përket shtetndërtimit demokratik, zhvillimit socio-ekonomik, por edhe sa iu përket njohjeve

ndërkombëtare, në veçanti normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, e që tash e kemi zgjidhjen: është marrëveshja bazike e njohjes së ndërsjellë de-facto", ka thënë Kurti.

Kryeministri Kurti është pyetur nëse do të kërkojë që ShBA-ja të ndërhyjë në dialogun për normalizimin e raporteve me Serbinë. "Nuk ka të bëjë me ShBA-në dhe BE-në. Këtu kemi të bëjmë me një emisar evropian që e ka deformuar procesin duke mos u përqendruar në zbatimin e plotë të marrëveshjes, por duke lejuar që qerrja të vihet para kuajve, Asociacioni një herë e pastaj shohim", është shprehur Kurti. Ai ka thënë se Lajçaku është duke bërë ndërmjetësim "të njëanshëm, aspak korrekt", gjë që, sipas Kurtit, nuk i duhet Kosovës.

Më tutje, shefi i qeverisë ka bërë me dije se përmes letrave i ka informuar më 15 shtator Uashingtonin, Berlinin, Parisin dhe Romën për ecurinë e takimeve në Bruksel.

I pyetur nëse do ta kërkojë zëvendësimin e Lajçakut në procesin e dialogut, Kurti ka thënë se zyrtari i lartë evropian nuk i jep llogari atij, por ai duhet t'i japë llogari Komisionit Evropian, Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian. "Unë besoj që ajo çfarë

kemi thënë këto ditë e fundit, në veçanti sot, është më se e mjaftueshme që të ketë llogaridhënie të tij atje (në institucionet evropiane)", ka thënë Kurti.

Në këtë konferencë për medie Kurti ka bërë një përmbledhje të ecurisë së takimeve dypalëshe dhe trepalëshe në Bruksel më 14 shtator. Ai i ka hedhur poshtë deklaratat e Brukselit se ai ka refuzuar një plan për sekuencimin e marrëveshjes bazë, duke thënë se ai në takim kishte dorëzuar një plan për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Kurti kishte kërkuar nga BE-ja të tregonte nëse Serbia kishte dorëzuar një dokument për zbatimin e marrëveshjes. Një dokumentin që i është dhënë në fund të takimeve, Kurti ka thënë se ai ishte i 19 korrikut, që ishte refuzuar gjatë takimit të kryenegociatorëve të Kosovës dhe të Serbisë në Bruksel të mbajtur në po atë datë. Sipas tij, ky dokument kërkonte që fillimisht të themelohej Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, pastaj të bëhej diskutimi për planin e BE-së, duke shtuar se dokumenti "ishte shndërruar në plan të ndërmjetësuesit".

Në këtë konferencë Kurti është pyetur edhe për masat ndëshkuese që BE-ja ka vendosur ndaj Kosovës

për shkak të mospërbushjes së kushteve të ndërkombëtarëve për uljen e tensioneve në veri të Kosovës.

Kryeministri Kurti ka thënë se që një kohë nuk ka tensione në veri dhe Kosova veçse ka reduktuar praninë policore atje dhe ka hartuar një udhëzim administrativ që mundëson largimin e kryetarëve të komunave përmes një peticioni. "Deeskalimi do të duhej të konsiderohej i mjaftueshëm për heqjen e masave", ka thënë Kurti.

Pas kësaj konference kanë reaguuar drejtuesit e opozitës në Kosovë. Deputetja e PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi, ka deklaruar se kryeministri Albin Kurti nuk është duke e mbrojtur interesin e Kosovës. Ajo ka thënë se Kurti është duke ia pasur frikën opozitës pasi nuk është duke raportuar në Kuvendin e Kosovës për takimet në Bruksel. "Se Albin i frikësohet opozitës fol vetë fakti që nuk po raporton në Kuvend. Klauzolat e nenet nuk i interesojnë askujt, mandatin e ke me i mbrojt interesat e vendit dhe mos me hup miq. As nuk je duke e mbrojtur interesin dhe as miq tanimë nuk ke", ka shkruar Musliu-Shoshi në "Facebook".

Ndërsa deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se raportimi i kryeministrit Albin Kurti para

## Haradinaj: Kosova në NATO është zgjidhja, jo anasjelltas

**PRISHTINË, 18 SHTATOR** - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se rendi dhe ligji duhen të forcohen në vend. Sipas tij, siguria dhe stabiliteti forcojnë edhe

ekonominë. "Rendi dhe ligji nuk kanë alternativë. Duhet të forcohen në të gjithë vendin, pa përjashtim. Siguria e përgjithshme lehtëson dhe shpejton rendin dhe ligjin. Siguria dhe stabiliteti, orcon

edhe ekonominë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Më tutje, Haradinaj ka thënë se Kosova në NATO është zgjidhje, jo anasjelltas. "Jo larg integriteteve euroatlantike për më shumë rend e ligj. E

kundërta. Sa më afër integriteteve dhe sa më shpejt në marrëdhënie kontraktuale me NATO-n, aq më shumë rend dhe ligj, aq më shumë ekonomi", ka shkruar Haradinaj.





# Abdixhiku përmend 50 nga 100 premtimet e programit "Rruga e re"

Prishtinë, 18 shtator - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka paraqitur 50 premtimet e para të programit "Rruga e RE" që përfshin 100 projekte. Nga premtimet e publikuara, Abdixhiku ka përmendur një shpërblym prej 5 000 eurosh për familjet të cilat vendosin të kenë tre fëmijë. Gjithashtu, premtim tjetër është publikuar edhe krijimi i Ministrisë për Familje dhe Mirëqenie si dhe krijimi i Ministrisë së Energjetikës. Më tutje, ai ka premtuar 200 milionë euro buxhet për ushtrinë e

Kosovës. Për këto premtime të publikuara nuk janë dhënë detaje se kur do të realizohen. Më tutje, Abdixhiku ka thënë se tash e tutje duan të flasin vetëm për të ardhmen. "Me bashkudhëtarët e Lidhjes - dhe jo vetëm - do ta shpalojmë secilin projekt në detaje. Do të hapim debate të gjera në gjithë vendin. Do ta shpalojmë të djathtë tonë si vlerë përparimtare dhe zhvillimore. Si antidot i zymtësisë së tanishme, si shërues i polarizimit përçarës, si shpërthim i ngufatjes në të shkuarën. Ne duam të flasim për të ardhmen. E



shkuara s'na kthehet më. S'kemi pse humbasim kohë. E ardhmja po na ikën përpara. Ne shohim një Kosovë më ndryshe. Ku urrejtja e brendshme zëvendësohet me unitet nacional. Ku akuzat, sharjet e ofendimet zëvendësohen me projekte të mëdha. Ku cinizmi zëvendësohet me ambicie e ëndrra që lehtësisht bëhen realitet. Duam të flasim për atdheun tonë si një vend që pasurohet siç dhe e meriton, me një shoqëri moderne e me një gjeneratë që e bën Kosovën të barabartë mes shteteve e kombeve evropiane", ka thënë Abdixhiku.

medieve lidhur me dialogun ishte "vajtim dhe dëshmi e paafësisë së tij për ta udhëhequr këtë proces". Hoti në "Facebook" ka renditur disa pika ku, sipas tij, ka gabuar kryeministri Kurti në procesin e negociatave. "Raportimi i sotëm para mediave lidhur me dialogun i kryeministrit ishte vajtim dhe dëshmi e paafësisë së tij që të udhëhequr këtë proces. Raportimi lidhur me dialogun duhet të bëhet në Kuvendin e Kosovës, siç e kërkon rezoluta e Kuvendit, ku thuhet: 'kryeministri raporton në Kuvend para dhe pas çdo takimi në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi'. Kujtojmë se në dy vite dialog, vetëm një informatë është dhënë në Kuvend nga Kryeministri në një seancë të kërkuar nga opozita", ka shkruar ai. Sipas tij, Kurti e ka degraduar dialogun dhe i ka shkaktuar dëm të madh vendit.



por ato janë menaxhuar keq dhe pa koordinim me aleatët nga ana e Qeverisë së Kosovës. Për herë të parë Kosova është e vetme në dialog karshi Serbisë. Fatkeqësisht, duket se Qeveria e Kosovës sot nuk e ka afër asnjë aleat për konsultime paraprake, siç ka ndodhur gjithmonë në procese negociatore të Kosovës me Serbinë", ka shkruar Hoti. Raundi i fundit i dialogut në Bruksel, më 14 shtator, ndërmjet presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe kryeministrit të Kosovës,

Albin Kurti, ka përfunduar pa përparim në normalizimin e marrëdhënieve. Ky ishte takimi i parë në mes të Vuçiqit dhe Kurtit pas shpërthimit të dhunës në veri të Kosovës në fund të majit. Nga Bashkimi Evropian thanë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk ka qenë i gatshëm të ecë përpara, ndryshe nga presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili "e ka pranuar propozimin e tyre" për zbatimin e Marrëveshjes Bazë për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi.

## Vuçiqi pret presion të ri për dialogun, paralajmëron zgjedhje në Serbi

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se pret "një presion të ri" nga Perëndimi ndaj shtetit të tij lidhur me bisedimet me Kosovën. "Ata në thelb u pajtuan me gjithçka që po bën (kryeministri i Kosovës) Albin Kurti dhe çështja e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është diçka që ata duhet ta bëjnë patjetër sepse marrëveshja për të është nënshkruar dhjetë vjet e gjysmë më parë dhe sepse ne insistojmë (në themelimin e Asociacionit)", ka thënë Vuçiqi për televizionin "Pink". Vuçiqi ka njoftuar për mundësinë që zgjedhjet në Serbi, që janë pjesë e kërkesave të opozitës, mund të mbahen më 4 mars 2024 apo një javë më herët. Këto

zgjedhje më herët janë caktuar për 31 dhjetor. "Jam i gatshëm të mbajmë zgjedhje në mars në përputhje me ato që ata (opozita) kanë shkruar", ka thënë Vuçiqi. Më 11 shtator përfaqësuesit e opozitës në Serbi, që kanë organizuar protestat "Serbia kundër dhunës", dhe kanë dorëzuar një kërkesë duke i kërkuar Vuçiqit të shpallë zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare dhe zgjedhje në Beograd deri në fund të vitit 2023. Kërkesa për zgjedhje të jashtëzakonshme është dërguar nga Partia Demokratike, Kryengritja Ekologjike, Fronti i Gjellbër dhe grupet parlamentare Lëvizja e Popullit të Serbisë dhe Drejtimi i Evropës.

## Bislimi i akuzon mediet për shtrembërim të deklaratës, por intervista për 'Danas'-in u përkthye nga zyra e kryeministrit



Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka hedhur akuza të rënda ndaj mediave të Kosovës, duke i akuzuar ato se paguhen nga Serbia dhe se ia kanë ndryshuar një deklaratë lidhur me njohjen formale dhe fjalën "lëshim". Por, kjo gjë nuk duket të jetë e vërtetë. Bislimi në konferencën për medie bashkë me kryeministrin Albin Kurti është përgjigjur për deklaratën e tij se Kosova ka bërë lëshim të madh pasi njohja formale nuk është e përfshirë në

Marrëveshjen e Ohrit. Mirëpo, Bislimi ka thënë se fjala lëshim është përdorur nga "mediet kosovare që kanë financimin nga Serbia". "Fjala lëshim është nga mediet kosovare që kanë financim nga Serbia, ky është koncesion që ka bërë Kosova ndaj Bashkimit Evropian, por jo Serbisë", ka thënë Bislimi. Megjithatë, Bislimi del se nuk e ka thënë të vërtetën në këtë konferencë pasi në intervistën e tij të publikuar dhe të përkthyer nga ai, shkruhet qartë dhe

përdoret fjala "lëshim". "Ne e kuptojmë se njohja formale nuk është aty dhe ky ishte një lëshim i madh i Kosovës", është thënë në intervistën të cilën mund ta gjeni në llogarinë e Bislimit në "Facebook", por edhe në uebfaqen e Qeverisë së Kosovës. Deklaratat e tij se Kosova ka bërë lëshime është raportuar në të gjitha mediet në Kosovë. Përndryshe nuk është hera e parë që Bislimi, por edhe zyrtarë të tjerë qeveritarë, bëjnë akuza të rënda ndaj mediave në Kosovë.

## Konjufca: Kosova e përkushtuar për paqe dhe integrim në institucionet evropiane

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për paqe dhe me synim integrimin në institucionet evropiane dhe organizatat ndërkombëtare.

Konjufca këto komente i ka bërë gjatë takimit njoftues me shefin e ri të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), Giovanni Pietro Barbano. "Kryetari i Kuvendit po ashtu u shpreh se Republika e Kosovës mbetet e

përkushtuar për paqe, shtet ligjor, siguri dhe mbrojtje të lirive dhe të drejtave të të gjithë qytetarëve të saj, si dhe për zhvillim të mëtejshëm të karakterit të patjetërsueshëm demokratik të shtetit tonë që synon integrim në institucionet

evropiane dhe organizatat ndërkombëtare", ka njoftuar Kuvendi i Kosovës. Ndërsa Barbano, duke e falënderuar kryetarin Konjufca për pritjen, ka rikonfirmuar gatishmërinë e misionit të EULEX-it për bashkëpunim të ndërsjellë



brenda mandatit të këtij misioni.



## Autobusi rozë fillon qarkullimin në rrugët e Prishtinës: Kush e bën monografinë, në tetor udhëton falas me 'Trafikun Urban'

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Autobusi ngjyrë rozë ka filluar qarkullimin të hënën në kryeqytet. Nisja është bërë në rrugën "Luan Haradinaj", konkretisht te "New Born"-i, në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për parandalimin e kancerit të gjirit. Drejtori i Shëndetësisë në komunën e Prishtinës, Izet

Sadiku, ka bërë me dije se shërbimi i mamografisë do të ofrohet falas në tri Qendrat e Mjekësisë Familjare (QKMF): në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, atë të lagjes "Dardania" dhe në QMF-në e "Veternik"-ut.

Ai i ka falënderuar ekipet e basketbollit të Trepçës e Pejës, lojtarët e të cilave do të veshin

bluzat "Race for the Cure Prishtina 2023" në shenjë mbështetje për fushatën e vetëdijesimit kundër kancerit të gjirit.

Ndërsa kryeshefi ekzekutiv i "Trafikut Urban", Burim Maraj, ka bërë me dije se të gjithë ato që bëjnë monografinë në tetor do të udhëtojnë falas me "Trafikun Urban".



## Komercialja refuzon ankesën e MINT-it, edhe në shkallën e dytë vendos në favor të "Klan Kosovës"

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale e ka refuzuar të pabazuar ankesën e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) në rastin e "Klan Kosovës".

Komercialja ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë të saj për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MINT-it.


"Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.315/23 i datës 02.08.2023, Vërtetohet", është thënë në vendimin e Komerciales.

Më 2 gusht të këtij viti po e njëjta gjykatë pati aprovuar ankesën e

"Klan Kosovës" për shtyrjen e vendimit të MINT-it rreth pezullimit të certifikatës së biznesit.

Në arsyetimin e kësaj gjykate ishte thënë: "I. Aprovohet si e bazuar kërkesa e paditësit Klan Kosova Sh.p.k., për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve". II. Shtyhet ekzekutimi i vendimit nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr. 309/11 i datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit".

Ky vendim ishte mirëpritur nga organizatat për lirinë e medias në Kosovë, ato ndërkombëtare, ambasadat si dhe shoqëria civile.



## Hyseni: Me lokacionin e ri të varrezave, Gjilani po bën zgjidhje të problemit për 100 vitet e ardhshme



GJILAN, 18 SHTATOR - Kuvendi i komunës së Gjilanit ka mbajtur të hënën një seancë të jashtëzakonshme, në të cilën ka vendosur lidhur me kërkesën e 14 këshilltarëve për çështjen e lokacionit të ri të varrezave si dhe Fshatit Social.

Pas një debati të gjerë dhe polarizues, propozim-vendimi për shpalljen e interesit publik për pronat në Shillovë për nevoja të varrezave të reja të qytetit është miratuar me 17 vota për dhe 14 abstenime, ndërsa kërkesa e Bashkësisë Islame për dhënie në shfrytëzim të Fshatit Social të Kuvajtit, për nevoja të medresesë, me 19 vota për, është shtyrë për një seancë tjetër.

Kërkesën e Bashkësisë Islame dhe arsyeshmërinë për lokacionin e ri të varrezave e ka paraqitur kryetari i komunës, Alban Hyseni, i cili ka thënë se zgjidhja e këtij problemi është interes i qytetarëve dhe obligim yni, meqë në hapësirën ekzistuese nuk ka më vend për varre të reja dhe se varrmihësit po hasin në eshtra njerëzish.

Duke i ftuar këshilltarët komunalë për miratimin e kësaj kërkesë, kryetari Hyseni ka thënë se me lokacionin e ri që ka rreth 20 hektarë sipërfaqe bëhet zgjidhje për 100 vitet e ardhshme. Sipas kryetarit të KBI, Naim Aliu, gjendja në varrezat ekzistuese është e mjerueshme. Ai ka

kërkuar nga anëtarët e Kuvendit që sot të vendosin përtej interesave e ndasive politike dhe ta miratojnë kërkesën për lokacionin e ri të varrezave. LDK-ja, e cila ka abstenuar në këtë pikë, ka thënë se nuk është kundër zgjidhjes së këtij problemi, përkundrazi ka kërkuar që të gjendet një zgjidhje tjetër, më e mirë dhe më e dinjitetshme, pasi që me Planin Zhvillimor Komunal kjo hapësirë është e planifikuar për zonë ekonomike.

Pas një debati mjaft polarizues edhe sa i përket Fshatit Social, Kuvendi ka vendosur me shumicë votash që kjo pikë të shtyhet për një seancë tjetër.

## Rreth 3 000 raste të dhunës në familje për një vit


PRISHTINË, 18 SHTATOR - Nga korriku i vitit të kaluar deri në fund të qershorit të këtij viti janë raportuar 2 800 raste të dhunës në familje. Nga këto raste janë 2 165 gra të cilat kanë

raportuar në polici dhunën që është ushtruar ndaj tyre. Kështu është thënë në mbledhjen konstituive të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me rastet e dhunës

seksuale dhe dhunës në familje.

Kryesuesja e këtij komisioni, Albana Bytyqi, ka thënë se mbi 80 për qind e të dyshuarve për dhunë në familje janë

burra, ndërsa 20 për qind e tyre janë gra. Më tutje, ajo ka thënë se në pesë muajt e parë të këtij viti në Policinë e Kosovës janë raportuar 37 raste të ngacmimit seksual.





## Mjekët nga Turqia do të kryejnë 16 operacione të fëmijëve me probleme në zemër

Prishtinë, 18 shtator - Të hënën në Kosovë ka arritur një ekip i mjekëve dhe ekspertëve nga Turqia të cilët do të realizojnë 16 operacione kardiokirurgjike te fëmijët me probleme në zemër në QKUK. Lajmi është dhënë nga Ministria e Shëndetësisë. Sipas njoftimit, mjekët janë pritur nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ambasadori i Turqisë në

Kosovë, Tunç Angili dhe drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar, Elvir Azizi. Me këtë rast, ministri Vitia dhe ambasadori i Turqisë, Tunç Angili, u kanë dëshiruar mirëseardhje ekspertëve dhe e kanë falënderuar ambasadorin turk për kontributin e vazhdueshëm që po jep për shëndetësinë e Kosovës. Në emër të ekipit të ekspertëve

ka folur Alper Guzeltas, i cili fillimisht ka thënë se ndihet i nderuar që është udhëheqës i ekipit dhe që ka mundësi të kontribuojë për fëmijët e Kosovës. Ekipi i mjekëve po qëndron në Kosovë në bashkëpunim dhe mbështetje të organizatës Muntada Aid, Kabir Miah, kurse koordinimin e punës e ka bërë doktori Ramush Bejiqi.



## Kurti dhe opozita replikojnë nga distanca për zgjedhjet e reja

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se do të zhduket opozita nëse shkohet në zgjedhje të reja parlamentare. Ndaj kësaj deklarate kanë reaguar përfaqësuesit e opozitës. Shefi i deputetëve të PDK-së, Alelard Tahiri, ka thënë se kurdo të mbahen zgjedhjet, Kurti nuk do të jetë më kryeministër. Ndërsa ai i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, e ka quajtur Kurtin humorist, duke thënë se kryeministri e ka humbur fuqinë politike

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka komentuar të hënën kërkesën e opozitës për dorëheqjen e tij dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare. Kurti ka lënë të nënkuptohet se nuk e ka ndërmend të japë dorëheqje. Madje ai me shpërfillje ka thënë se nëse shkohet në zgjedhje, sipas tij, do të zhduket opozita. "Kam dëgjuar që opozita herë kërkon dorëheqjen e herë shkarkimin tim e herë zgjedhje të reja. Zgjedhjet nuk i konvenojnë as qeverisë, as opozitës. Qeverisë nuk i konvenojnë zgjedhjet sepse zhduket opozita", ka thënë Kurti në një konferencë për medie të hënën në të cilën ka folur për takimin e fundit në Bruksel.

Ndaj kësaj deklarate të Kurtit kanë reaguar përfaqësuesit e opozitës. Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka thënë se kurdo që të mbahen zgjedhjet, Albin Kurti nuk do të ketë mundësi të krijojë një qeveri të dytë pasi, sipas tij, "nuk do t'i ketë as numrat e as mandatin". "Mendoj që favori dhe shërbimi më i madh që do t'ua bëjë Kurti qytetarëve është të japë dorëheqje dhe të shkojmë në zgjedhje. Qeveri në mandatin e ardhshëm kur do që të mbahen



zgjedhjet, ai (Kurti) nuk do ta mund ta krijojë. Ky është mandati i tij i fundit dhe nuk do të mund të krijojë një mandat të ri. Ju e shihni agjendën parlamentare", ka thënë Tahiri pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Ai ka thënë se dorëheqja e Kurtit do t'i ndihmojë Kosovës t'i hiqen sanksionet nga Bashkimi Evropian (BE). "Tash Kurtit kanë filluar që t'i dalin pengesa edhe nga BE-ja. Ai e ka të pamundur të

qeverisë dhe ta nxjerrë vendin nga kjo situatë. Dorëheqja e tij do të garantojë që vendit tonë t'i hiqen sanksionet. Një kryeministër që i ka humbur rruga në oborr, mendoj se dorëheqja e tij është shërbimi më i madh që Kurti mund t'i bëjë vendit tonë. Nuk ka nevojë Kurti të brengoset për opozitën. Brengë për të është humbja e pushtetit", ka thënë Tahiri.

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, e ka quajtur kryeministrin Albin Kurti humorist, duke thënë se ai e ka humbur fuqinë politike. Sipas Tahirit, Kurti nuk ka kujdes as ndaj njerëzve të Lëvizjes Vetëvendosje, "e lërë më për opozitën dhe partitë e tjera". Më tutje, Tahiri e ka ftuar Kurtin të përballet me zgjedhje. "Kryeministri Kurti ia ka filluar të bëhet humorist. Ky asnjëherë s'ka pasur kujdes për opozitën, lërë për

opozitën e partitë e tjera, por as për njerëzit ndryshe në partinë e vet. Nuk kujdeset për njerëzit në parti që kanë mendime të ndryshme e lërë për partitë e tjera. Se kush sa e ka fuqinë politike na e jep populli. Le të dalë nëse ia mban në zgjedhje dhe e sheh çka ndodh me të. Ai e di që e ka humbur fuqinë elektorale politike, prandaj është bërë humorist", ka thënë Tahiri pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

## Të enjten mbahen dy seanca, Kusari-Lila e brengosur për mosvotimin e marrëveshjeve ndërkombëtare

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë me dije se në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit është vendosur që të enjten të mbahet dy seanca. Ajo ka sqaruar se të enjten do të votohet Komisionit Hetimor Parlamentar për rezervat shtetërore. Sipas saj, sfida mbetet moskalimi i marrëveshjeve ndërkombëtare. "U mor vendim që të enjten të vazhdojë seanca me pikat e papërfunduara, pastaj duhet

të fillojë një seancë e re e kërkuar nga 40 deputetë për krijimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për rezervat shtetërore. Në atë seancë do të bëhen propozimet e anëtarëve nga grupet parlamentare për këtë komision. Do të mbetet sfida edhe çështje e marrëveshjeve ndërkombëtare, numri i të cilave vetëm po rritet. Në seancën e 28 korrikut, e cila do të vazhdojë tash më 21 shtator, janë pesë marrëveshje ndërkombëtare

të cilave u shtohen edhe shtatë të tjera", ka thënë Kusari-Lila.

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka theksuar se formimi i Komisionit Parlamentar për keqpërdorimet e rezervave shtetërore do të jetë jashtëzakonisht i rëndësishëm. "Ky hetim është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Besoj se do të ndihmojë në hedhjen në dritë për të gjitha ato keqpërdorime të rezervave shtetërore", ka thënë Tahiri.





## ATK-ja ndryshon procedurat e pajisjes me vërtetim tatimor

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se bazuar në Ligjin në fuqi për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe në përputhje me Ligjin nr. 08/L-176 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, ka nxjerrë udhëzuesin me të cilin ka plotësuar/ndryshuar procedurat e pajisjes me vërtetim tatimor. Qëllimi i këtij udhëzuesi është informimi i personave/tatimpaguesve për procedurat që duhen ndjekur për t'u pajisur me vërtetim tatimor, përgjegjësitë e zyrtarëve të shërbimit dhe edukimit të

tatimpaguesve në drejtoritë rajonale për ta lëshuar vërtetimin tatimor, si dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të teknologjisë informative në ATK për ta mundësuar gjenerimin e vërtetimit tatimor. Pajisja me vërtetim tatimor mund të bëhet në mënyrë elektronike dhe në mënyrë manuale. Tatimpaguesi (biznesi) mund të pajiset me vërtetim tatimor online përmes Sistemit Elektronik EDI apo në zyrën përkatëse rajonale të shërbimit dhe edukimit të tatimpaguesve. Ndërsa personi fizik joafarist (individ) mund të pajiset me vërtetim tatimor online përmes uebfaqes së ATK-së apo përmes linkut <https://evertetimi.atk-ks.org/> apo në cilëndo zyrë rajonale



më të afërt të shërbimit dhe edukimit të tatimpaguesve. Vërtetimi tatimor për personat fizikë afaristë dhe personat juridikë lëshohet nga ATK-ja vetëm: në rastet kur tatimpaguesi nuk ka ndonjë detyrim tatimor të pashlyer, në rastet kur

tatimpaguesi ka obligime të pashlyera, mirëpo është në marrëveshje për pagesë të atij borxhi me këste si dhe në rastet kur personi është i regjistruar në ATK dhe ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera, mirëpo është në procedurë të ankesave në

Divizionin e Ankesave. Ndërsa vërtetimi tatimor për personat fizikë joafaristë (individët) lëshohet nga ATK-ja vetëm: në rastet kur personi nuk ka ndonjë detyrim tatimor të pashlyer, në rastet kur personi ka obligime të pashlyera, mirëpo është në marrëveshje për pagesë të atij borxhi me këste, kur personi është i regjistruar në ATK dhe ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera, mirëpo, është në procedurë të ankesave në Divizionin e Ankesave si dhe në rastet kur ATK-ja nuk ka shënime për personin. Ky udhëzues do të fillojë të zbatohet 1 tetori i këtij viti dhe i njëjti shfuqizon "Udhëzuesin lidhur me procedurat e pajisjes me vërtetim tatimor" të datës 14 tetor 2020.

## BQE-ja rrit normën e interesit në 4 për qind, niveli më i lartë që dy dekada

FRANKFURT, 18 SHTATOR - Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka rritur sërish normën e interesit me 25 pikë përqindje, pra në 4 për qind, që është niveli më i lartë që nga fillimi i monedhës euro më 1999. Sipas BQE-së, edhe pse inflacioni vazhdon të bie, ky vazhdon të mbetet shumë i lartë për një kohë të gjatë. "Inflacioni vazhdon të bjerë, por ende pritet të mbetet shumë i lartë për një kohë të gjatë. Këshilli Drejtues është i vendosur të sigurojë që inflacioni të kthehet në objektivin e tij afatmesëm prej 2-përqindësh në kohën e duhur. Për ta përforcuar progresin drejt objektivit të tij, Këshilli Drejtues vendosi sot t'i rrisë tre normat kryesore të interesit të BQE-së me 25 pikë bazë", ka theksuar BQE-ja. Institucioni më i lartë financiar i BE-së la të kuptohet se mund



të mos ketë më nevojë të rrisë më tej normat, megjithëse tha se mbetet i varur nga të dhënat. "Normat kryesore të interesit të BQE-së kanë arritur nivele që, të mbajtura për një kohëzgjatje mjaft të gjatë, do të

japin një kontribut të konsiderueshëm në kthimin në kohë të inflacionit në objektiv. Këshilli Drejtues do të vazhdojë të ndjekë një qasje të varur nga të dhënat për ta përcaktuar nivelin e duhur

dhe kohëzgjatjen e kufizimit", ka theksuar BQE-ja. Eurozona në tërësi e ka shmangur recesionin deri më tani, por Gjermania, ekonomia më e madhe e saj, ka pësuar turrje. Nuk janë

vetëm normat më të larta të interesit që po rëndojnë aktivitetin ekonomik. Një tjetër faktor ishte edhe frika nga mungesa e gazit natyror pas pushtimit rus të Ukrainës vitin e kaluar. Po kështu është edhe dobësia në Kinë, ku mbështetet shumë industria prodhuese e Gjermanisë. Në të njëjtën kohë, norma e inflacionit në Eurozonë qëndron në 5.3 për qind, ende shumë larg mbi objektivin prej 2-përqindësh të BQE-së. Edhe pse ka rënë nga kulmi prej 10.6-përqindësh në tetor, parashikohet të vijojë në këto nivele për disa kohë. Komisioni Evropian në fillim të kësaj jave uli parashikimet për zgjerimin ekonomik dhe tha se inflacioni do të vazhdojë të jetë mesatarisht më shumë se 3 për qind në vitin 2024.

## Hoti: Trendi rënës i ekonomisë po vazhdon gjatë gjithë mandatit të kësaj qeverie

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se trendi rënës i ekonomisë është duke vazhduar gjatë gjithë mandatit të Qeverisë Kurti. Hoti ka theksuar se rritja ekonomike e vendit është shafitur në nivele të ulëta. "Trendi rënës i ekonomisë po vazhdon gjatë gjithë mandatit të kësaj qeverie - që nga tremujori i dytë i vitit 2021 kur e nisën mandatin. Pa zot shtëpie që kujdeset për ekonominë e bashkëpunon me sektorin privat, rritja

ekonomike është shafitur në nivele të ulëta që as amortizimi i kapitalit nuk mbulohet", ka shkruar Hoti në "Facebook". Sipas tij, në tri vite të qeverisjes nuk ka asnjë politikë ekonomike e fiskale që siguron punësim e prodhim të qëndrueshëm. "Kjo ka qenë e pritshme. Në tri vite të qeverisjes, nuk ka asnjë politikë ekonomike e fiskale që siguron punësim e prodhim të qëndrueshëm. Investimet publike në tri vitet e fundit janë tkurrur jashtëzakonisht shumë. E gjithë politika ekonomike është reduktuar në subven-

cione, të cilat mundësojnë mbijetesë, por jo zhvillim", ka shkruar Hoti. Prodhimi i Brendshëm së Kosovës (PBB) ka shënuar rritje reale për 2.02 për qind në tremujorin e dytë të këtij viti. Kështu ka bërë me dije Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), duke shtuar se rënia e eksporteve të mallrave kanë shënuar rënie për rreth 11 për qind. "PBB-ja në tremujorin e dytë 2023 shënon rritje reale për 2.02 për qind, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak", ka njoftuar ASK-ja.





# Derna, përse përmbytja ishte kaq katastrofike

Më shumë se 11,000 persona kanë vdekur dhe mijëra të tjerë janë të zhdukur pas përmbytjeve shkatërruese që përfshinë qytetin port libian të Dernas.

Lagje të tëra u zhdukën në det teksa uji i ardhur si cunam pushtoi qytetin.

Familje të tëra u shpërndanë, sipas një gazetari libian, i cili foli me të mbijetuarit në qytet, dhe e përshkroi situatën si “përtej katastrofikes”.

BBC Verify dhe ekipi i gazetarisë vizuale të BBC-së kanë analizuar disa nga arsytet pse përmbytjet shkaktuan dëme kaq katastrofike në Derna.

## Reshje rekord

Reshjet u shkaktuan nga stuhia Daniel që goditi Libinë të dielën. Stuhia – një sistem mesdhetar i ngjashëm me uraganin i njohur si medicane – solli më shumë se 400 mm shi në pjesë të bregdetit verilindor, brenda një periudhe 24-orëshe.

Ky është një përmbytje e jashtëzakonshme për një rajon që zakonisht sheh rreth 1.5 mm shi gjatë gjithë shtatorit.

Qendra Kombëtare Meteorologjike e Libisë thotë se ky është një rekord i ri reshjesh.

Të dhënat satelitore tregojnë shtrirjen e reshjeve në të gjithë rajonin – megjithëse në shumë vende sasia e regjistruar në tokë ishte më e lartë.

Është shumë herët që t’ia atribuosh me siguri forcën e kësaj stuhie, rritjes së temperaturave globale.

Megjithatë, ndryshimet klimatike mendohet se po rrisin frekuencën e ngjarjeve të tilla të forta.

Prof Liz Stephens, një eksperte në rreziqet klimatike dhe



qëndrueshmërinë në Universitetin Reading në Mbretërinë e Bashkuar, thotë se shkencëtarët janë të bindur se ndryshimi i klimës po shton reshjet e lidhura me stuhitë të tilla.

## Dy diga të mbingarkuara

Lumi Uadi Derna rrjedh nga malet e brendshme të Libisë, përmes qytetit të Dernas dhe në Mesdhe.

Është i thatë për pjesën më të madhe të vitit, por shiu jashtëzakonisht i madh përmbytje dy diga të rëndësishme dhe shkatërroi disa ura.

Banorët e qytetit, të cilët ishin urdhëruar nga autoritetet lokale të qëndronin në shtëpi, raportuan se kishin dëgjuar një shpërthim të fortë përpara se

qyteti të pushtohej nga uji. “Diga fillimisht e kanë ujin, dhe shpërthimi i tyre ka çliruar të gjithë ujin me një lëvizje. Mbetjet e ndodhura në ujërat e përmbytjeve e kanë shtuar fuqinë shkatërruese”, thotë Prof Stephens.

Diga e sipërme kishte një kapacitet depozitues prej 1.5 milion metra kub ujë, ndërsa diga e poshtme mund të mbante 22.5 milion metra kub.

Çdo metër kub ujë peshon rreth një ton (1000 kg), kështu që 1.5 milion metër kub ujë peshojnë .5 milion ton.

Shtoji asaj peshe lëvizjen tatëpjetë dhe mund të prodhohet një fuqi e jashtëzakonshme. Dëshmitarët kanë thënë se ujërat kanë qenë afro tre metra në disa vende.

Vlerësohet se 20 cm ujë nga vërshimet me lëvizje të shpejtë janë të mjaftueshme për të rrëzuar dikë dhe 60 cm mjaftojnë për të notuar një makinë. Pra, nuk është çudi që ndërtesa të tëra u shembën nga përmbytjet. Ekspertët thonë se është shumë herët për të ditur nëse reshjet ekstreme ishin thjesht të tepërta për t’u përballuar nga digat, apo nëse gjendja e strukturave gjithashtu luajti një rol.

Bazuar në vëzhgimet e tyre, digat ka të ngjarë të bëhen nga dheu ose gurë të hedhur dhe të ngjeshur, të cilat nuk janë aq të forta sa betoni.

“Këto diga janë të ndjeshme kur uji tejkalon kapacitetin e tyre dhe ndërsa digat e betonit mund t’i mbijetojnë, digat me mbushje me gurë zakonisht nuk

munden,” thotë Prof Dragan Savic i Universitetit të Exeter, një ekspert në inxhinierinë hidraulike.

Duket se diga e sipërme u çua e para, sipas inxhinierit strukturor Andrew Barr.

Ai thotë se uji më pas me siguri ka rrjedhur poshtë luginës së lumit shkëmbor drejt digës së poshtme përpara se ta çante dhe atë, duke rezultuar në përmbytjen e papritur dhe katastrofike të qytetit që shtrihet i bllokuar midis maleve dhe detit. Një studim i botuar vitin e kaluar mbi hidrologjinë e pellgut të Uadi Dernas theksonte se zona “ka një potencial të lartë rrezikun nga përmbytjet”, në bazë të vëllimeve të mundshme historike të përmbytjeve dhe se digat “kishin nevojë për mirëmbajtje periodike”.

Raporti, nga eksperti i inxhinierisë civile Abdeluanes AR Ashoor nga Universiteti libian i Omar Al-Mukhtar, tha se “situata aktuale në pellgun e luginës Derna kërkon që zyrtarët të marrin masa të menjëhershme, duke kryer mirëmbajtjen e rregullt të digave ekzistuese, sepse në rast të një përmbytjeje të madhe, rezultati do të jetë katastrofik për banorët e luginës dhe qytetit”.

Disa ekspertë kanë theksuar rolin e mundshëm që ka luajtur paqëndrueshmëria politike në Libi në mirëmbajtjen e digës.

Ndërsa përpjekjet e shpëtimit në qytet vazhdojnë, gazetari libian Johr Ali, i cili ka folur me të mbijetuarit në qytet, tha për BBC: “Njerëzit po dëgjojnë klithmat e foshnjave nën tokë, ata nuk dinë si t’i shpëtojnë. Po përdorin lopata për të marrë trupat nga poshtë tokës, po përdorin duart. Të gjithë thonë se është si dita e gjykimit.” / BBC – Bota.al




PARA



PAS



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Njësëri: Dhuna nuk ka vend në sport

Federata e Basketbollit, Ministria e Sportit dhe KB Trepça e kanë dënua dhunën në finalen e Superkupës në basketboll, në të cilën ka pasur edhe të lënduar, përfshirë edhe gazetaren sportive Ulpiana Emra. Të gjithë njëzëri kanë kërkuar që personat e tillë që fshehen prapa tifozëve nuk duhet të kenë vend në palestrat sportive dhe të gjithë duhet të angazhohen që dhuna të jetë sa më larg sportit

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 18 SHTATOR** - KB Trepça ka dënua ngjarjet e dhunshme që ndodhen gjatë dhe pas finales së Superkupës në ndeshjen Trepça - Peja. Sipas klubit mitrovicës, sjelljet e disa individëve që përipiqen të kamuflohen brenda grupeve të tifozëve po e prishin imazhin e klubit. "Klubi i Basketbollit Trepça shpreh shqetësimin për disa episode jo të mira gjatë dhe pas finales së Superkupës së Kosovës në basketboll, Trepça - Peja, e zhvilluar të dielën në Suharekë. Klubi i Basketbollit Trepça angazhohet maksimalisht për sjellje të dinjitetshme të të gjithë aktorëve në ndeshjet e

basketbollit, duke përfshirë shikuesit në tribuna. Në të njëjtën kohë klubi ynë dënon sjelljen e disa individëve të caktuar që përipiqen të kamuflohen brenda grupeve të tifozëve, që i bëjnë dëm klubit tonë, imazhit të klubit dhe basketbollit në përgjithësi", thuhet në reagimin e KB Trepça. "Jemi të përkushtuar t'i luftojmë dukuritë negative dhe nga ndeshja e ardhshme do të ketë masa të rrepta ndaj atyre individëve që me veprimet e tyre bien ndesh me misionin e klubit dhe basketbollit kosovar. Gjithë tifozët i urojmë për suksesin e arritur, në të njëjtën kohë i lusim për kujdes që të distancohen nga individët që me veprimet e tyre i sjellin dëm klubit tonë", thuhet në reagimin e



skuaadrës mirtovciase. Lidhur me dhunën në finalen e Superkupës ka reaguar edhe zëvendësministrja e sportit, Daulina Osmani. Ajo i ka quajtur të papranueshme incidentet që ndodhën në Suharekë në ndeshjen Trepça - Peja, me ç'rast u lëndua edhe gazetaria sportive Ulpiana Emra, derisa ka paralajmëruar se një prej vendimeve mund të jetë ndalimi i tifozëve nëpër palestra për shkak të dhunës që po e shfaqin. "Sulmi i sotëm në gazetaren sportive Ulpiana Emra është i papranueshëm të

justifikohet në emër të mbështetjes së ekipeve të zemrës. Gjuha dhe sjellja e urretjes nuk duhet të gjejnë vend në sportin tonë. Federata e Basketbollit e Kosovës duhet të ndërmarrë masa të rrepta për parandalimin e përsëritjes së situatave të tilla. Nëse përgjigja është ndalimi i tifozëve në palestra sportive, atëherë do të obligohemi të ndërmarrim diçka të tillë për këtë sezon në basketboll. Duhet të kuptojmë se sjelljet e tilla po e dëmtojnë imazhin e sportit si përbrenda vendit, po aq dhe jashtë vendit. Nuk ka asnjë fitues në këtë

mes. Ndërsa dëmi është i përbashkët. Për këtë ata që janë përgjegjës duhet të japin përgjegjësi pranë organeve të rendit", thuhet në reagimin e Osmanit.

Dhunën e shfaqur në Suharekë e ka dënua edhe Federata e Basketbollit e Kosovës. "Veprimet e tilla, dhuna dhe urretja e shfaqur nga një numër shikuesish të ndeshjeve të basketbollit, janë të papranueshme dhe nuk do të tolerohen nga Federata e Basketbollit e Kosovës dhe autoritetet e vendit. Aktet e dhunës dhe huliganizmi që aktorët e ndeshjes i përjetuan brenda dhe jashtë palestrës nuk mund të tejkalojnë apo injorohen nga Federata e Basketbollit apo nga klubet e basketbollit në emër të të cilave këta individë të papërgjegjshëm veprojnë, apo edhe nga autoritetet e rendit të cilat mbrëmë e patën shumë të vështirë, në disa çaste edhe të pamundshme që ta kontrollojnë turmën brenda dhe jashtë palestrës", thuhet në reagimin e FBK-së.

## Përfundon procedura e shpronësimit për rinovimin e stadiumit 'Adem Jashari'

**MITROVICË, 18 SHTATOR** - Stadiumi "Adem Jashari" në Mitrovicë tash e disa vjet ka mbetur jashtë funksionimit për shkak të demolitimit të tij, por duket se ai do t'i rikthehet normalitetit shumë shpejt. Qeveria e Republikës së

Kosovës javë më parë ka ndarë 12 milionë euro për rinovimin e tij, derisa tashmë ministri i Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka njoftuar se tashmë kanë përfunduar edhe procedurat e

shpronësimit gjë që i hap rrugë nisjes së punimeve për rinovimin e tij. "Kemi përfunduar të gjitha procedurat e shpronësimit për rinovimin e stadiumit të Mitrovicës 'Adem Jashari'. Edhe pse shpronësimi solli vonesa në ecurinë e këtij projekti shumë të rëndësishëm, pas një koordinimi dhe bashkëpunimi të suksesshëm ndërinstucional, kemi përfunduar të gjitha procedurat e shpronësimit, në mënyrë që Stadiumi i Mitrovicës 'Adem Jashari', më në fund të vihet në rrugën e duhur, kështu që të jetësohet e ta gëzojnë të gjithë qytetarët", ka shkruar Aliu në "Facebook".

Pak ditë më parë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka marrë vendim për ndërtimin e stadiumit të qytetit në Gjilan me kosto prej 15 milionë eurosh.



## Liga e Kampionëve fillon me superndeshjen PSG - Dortmund



TË MARTËN TAKOHEN:

21:00 Feyenoord - Celtic  
21:00 Lazio - Atletico Madrid  
18:45 AC Milan - Newcastle United  
21:00 Paris Saint Germain - B. Dortmund  
18:45 Young Boys - RB Leipzig  
21:00 Manchester City - FK Crvena Zvezda  
21:00 Barcelona - Royal Antwerp  
21:00 Shakhtar Donetsk - FC Porto

**PARIS, 18 SHTATOR** - Liga e Kampionëve në edicionin 2023/2024 do të nisë me superndeshje. Kampioni i Francës, Paris Saint Germain, në "Parc des Princes" e pret Borussia Dortmundin dhe padyshim se pritet të jetë një ndeshje e zjarrtë futbollit, pasi të dyja skuadrat janë cilësore dhe do të përipiqen të nxjerrin sa më të mirën për faktin se janë në grupin e "vdekjes" ku bëjnë pjesë edhe Milani dhe Newcastle United. Edhe këto dy të fundit përballen sonte nga

ora 18:45 dhe normalisht se kuqezinjtë kërkojnë fitore. Skuadra e shqiptarit Arbnor Muja, Royal Antwerp, është mysafire e Barcelonës, kurse kampioni në fuqi i Ligës së Kampionëve, Manchester City, e pret Crvena Zvezdan.

## Nuza ndan drejtësinë në ndeshjen Ludogorets - Spartak Trnava

**PRISHTINË, 18 SHTATOR** - Për herë të dytë që nga debutimi në arenën evropiane, Genc Nuza do ta ndajë drejtësinë në fazën e grupeve në Ligën e Konferencës. Në fakt, UEFA

ia ka besuar Nuzës ndeshjen ndërmjet skuadrës bullgare Ludogorets dhe asaj sllovaqe Spartak Trnava në kuadër të Grupit H, e cila zhvillohet të enjten në Razgrad në orën 18:45.

Nuzës do t'i asistojnë Bujar Selimaj e Fatlum Berisha, ndërsa derisa gjyqtar i katërt do të jetë Erdall Zaseja. Në VAR do të jenë gjyqtarë zviceranë. Të rikujtojmë se Genc

Nuza është i përfshirë edhe në programin "Mentor&Talent", ku janë të përfshirë 20 gjyqtarë më me perspektivë evropiane për edicionin 2023/24.





## Muriqi për trazirat në Rumani: Politika nuk duhet të përzihet me futbollin

PRISHINË, 18 SHTATOR - Në ndeshjen kualifikuese për Kampionatin Evropian mes Rumanisë dhe Kosovës nuk munguan incidentet. Ultrasit e pranishëm në "Arena Nationala" të Bukureshtit filluan të thërrisnin

në kor: "Serbia, Serbia" e përveç kësaj, shpalesën në tribunën prapa portës një pankartë me ngjyrat e flamurit serb me mbishkrimin "Kosova është Serbi". Lidhur me këto trazira ka folur sulmuesi i Kosovës, Vedat

Muriqi. Sulmuesi "dardan" ka thënë se politika nuk duhet të përzihet asnjëherë në sport. "Njerëzit harrojnë se ne të gjithë jemi njerëz dhe një ditë do të vdesim të gjithë. Pse të mos jetojmë të gjithë në paqe? Pse e

sjellin politikën në futboll? Futbollin na bashkon, na bën të gjithëve ta shijojmë atë dhe ata shkojnë t'i vendosin ato pankarta, por në fund të ditës njerëzit thonë çfarë të duan, ne nuk mund t'i ndalojmë", ka thënë Muriqi.



## 'US Open' përmbys renditjen në të dyja kategoritë

NJU-JORK, 18 SHTATOR - Triumfi në grand slam të US Open ka rikthyer tenistin serb Novak Djoković në krye të renditjes botërore, me 11 795 pikë. Ai ka zbritur nga froni spanjollin Carlos Alcaraz, që tashmë ndodhet 3 000 pikë pas serbit. Në vendin e tretë ndodhet sërish rusi Daniil Medvedev. Edhe te femrat ka ndryshime në krye të renditjes. Në vendin e parë ndodhet tenistja bjelloruse Aryna



Sabalenka. Ajo humbi në finalen e "US Open", por gjithsesi rrimben kreun e renditjes, duke zbritur në vendin e dytë polaken Iga Swiatek. Fituesja e "US Open" për femra,

Coco Gauff, ngjitet në vendin e tretë, ende 3 000 pikë larg kreut, por muajt e fundit kanë qenë të shkëlqyer për të, duke ngjitur shpejt shkallët e renditjes.

### MESHKUJ

1. Novak Djoković	11.795 pikë
2. Carlos Alcaraz	8.535
3. Daniil Medvedev	7.280
4. Holger Rune	4.710
5. Stefanos Tsitsipas	4.615

### FEMRA

1. Aryna Sabalenka	9.266 pikë
2. Iga Swiatek	8.195
3. Coco Gauff	6.165
4. Elena Rybakina	5.790
5. Jessica Pegula	5.755

## Ferrari në 'qiellin e shtatë': Në Singapor gjithçka ishte e përkryer



MORENA, 18 SHTATOR - Carlos Sainz shijon fitoren që arriti një ditë më parë në pistën e Marina Bay në Singapor. Ky është suksesi i parë i "kokëkuqes" këtë sezon të Formula 1, që ndali dominimin e Red Bullit, në një garë ku makina italiane ishte më e shpejta në pistë. Piloti spanjoll, duke komentuar këtë sukses, ka thënë: "Një ndjesi e jashtëzakonshme. Falënderoj Ferrarin, pasi ka bërë një

sforco të jashtëzakonshme për t'u rikthyer te fitorja pas një fillim-sezoni të vështirë. Në Singapor gjithçka ishte e përkryer. Duhej t'i menaxhohim mirë gomat dhe gjithçka funksionoi më së miri dhe arritëm të shkojmë deri në fund, duke qenë makina më e mirë. Doja ta ruaja ritmin, ta menaxhohim situatën, duke çuar makinën në fund në vendin e parë. Jemi në qiellin e shtatë", ka deklaruar

Carlos Sainz. Piloti tjetër i "kokëkuqes", monogasku Charles Leclerc, u rendit i katërti, por gara e tij ishte një garë sakrifice, duke e ndihmuar shokun e skuadrës të shkëputej e mbante pas rivalët. "Ishte normale që gjërat të shkonin kështu. Këtë strategji e kishim diskutuar edhe para garës. Rëndësi ka fitorja dhe menaxhimi që i bëmë makinës", ka shtuar Leclerc.

### SHKURT

#### Muja në formacionin e javës në Belgjikë

Sulmuesi nga Kosova, Arbnor Muja, u aktivizua në minutën e 64-t, por shkëlqeu në Antwerp të Belgjikës. Muja asistoi për 2-0 në minutën e 68-të dhe shënoi për 3-0 në minutën e 84-t. Antwerpi fitoi 3-0 në rrugën drejt Westerlos të premtën mbrëma. Ndeshja u zhvillua në kuadër të xhiros së shtatë të kampionatit belg. Antwerp ka 11 pikë nga gjashtë ndeshje. Muja është zgjedhur në formacionin më të mirë të javës në Belgjikë.

Formacioni: Suzuki, Hashioka, Kandouss, Mechele, Bataille, Kums, Kawabe, Muja, Steuckers, Nusa, Jutgla.

#### Eriksen: Na duhet pak fat për të dalë nga kjo krizë

Manchester Unitedi nuk po e kalon momentin më të mirë. Në pesë ndeshjet e para të Premierë Ligës ka arritur të regjistrojë dy fitore dhe tri humbje. Mesfushori danez Christian Eriksen lidhur me këtë situatë ku ndodhen "djajtë" ka thënë se duhet pak "fat" për të dalë nga kjo krizë. "Është një humbje e rëndë. Duhet të analizojmë veten. Kemi ndryshuar disa gjëra, por jemi të zhgënjyer. Na mungojnë gjërat e vogla dhe pak fat. Ne kemi nevojë për ta kapërcyer krizën", ka thënë Eriksen.

#### Henry: Messi nuk mund të ishte 'bossi' në ekip me Mbappen dhe Neymarin

Legjenda e Arsenalit, Thierry Henry, ka deklaruar se nuk ishte e mundur që Lionel Messi të luante futbollin e tij më të mirë në PSG së bashku me Kylian Mbappe dhen Neymarin. Fituesi i Kupës së Botës shënoi 32 gola në 75 paraqitje gjatë kohës së tij në kryeqytetin francez, duke fituar radhazi titujt e Ligës 1. Thashethemet për prishjen e marrëdhënies me sulmuesit e tjerë Mbappe dhe Neymar dominuan në muajt e fundit të sezonit të kaluar. Henry, i cili kohët e fundit u bë trajner i skuadrës së Francës U21, foli për treshen e famshme të PSG-së dhe rolin e Lionel Messit në skuadër. "Po flisja për strukturën, organizimin. Si luanin me të tre: Messi, Neymar dhe Mbappe, në të njëjtën kohë? Kur Messi luajti me skuadrën e Argjentinës kishte një strukturë. Nuk ka tre Messi. Është vetëm ai. Ju e vendosni atë në kornizë ku vetëm ai është shefi dhe ai do të shkëlqejë", ka thënë Henry.

#### Mourinho: Nuk luajtëm për të fituar 7-0

AS Roma ka shënuar fitoren e parë në këtë edicion të Serisë A, pasi ka mposhtur Empolin me rezultat 7-0. Trajneri i Romës, Jose Mourinho, ka thënë se nuk luajtëm në atë mënyrë për të fituar 7-0, teksa ka deklaruar se i vjen keq për Empolin. "Duhet të mendoj ndryshe. Ne luajtëm mirë, por jo për të fituar 7-0. Është diçka që ndodh, nuk është se luan për të fituar me një rezultat si ky. Kemi luajtur një ndeshje të mirë, jo me uniformitet, por me shume ulje-ngritje. Në nivel fizik mund të shohësh që ka lojtarë që nuk kanë kushtet për të luajtur një ndeshje 90 minuta", ka thënë Mourinho. "Rezultati 7-0 ndodh. Më vjen keq për Empolin, por ky është futboll dhe ndonjëherë ndodh", u shpreh Mourinho.

## Hummelsi mund të pensionohet në fund të sezonit

Mbrojtësi gjerman Mats Hummels mund të tërhiqet nga futbollin në fund të këtij sezoni, kur dhe i skadon kontrata me skuadrën Borussia Dortmund. 34-vjeçari këtë sezon nuk ka



luajtur në asnjë ndeshje në Bundesliga (vetëm 1 ndeshje në Kupë) dhe duket se karriera e tij është në fund. Sipas së përditshmes gjermane "Bild", Hummels, kampion bote me

Gjermaninë në vitin 2014, po mendon tërheqjen nga sporti. Në karrierën e tij, Hummels ka luajtur edhe për 3 sezone me Bayern Munchenin. Për klubin ai është një lojtar i

rëndësishëm për ta mbajtur grupin të bashkuar. Për Hummelsin mendohet se mund të vijë një ofertë e mirë edhe nga Arabia Saudite, por duket se tërheqja përfundimtare nga

sporti është ideja më e mirë. Lojtari ende nuk ka biseduar me klubin për të ardhmen që mund t'ia rinovojë edhe për një vit kontratën për ta pasur edhe për një sezon.



	Kuvendi Komunal Malishevë Drejtoria Komunale e Arsimit	
	IAAP "Lasgush Poradeci" Kijevë	"LASGUSH PORADECI" KIJEVË

Nr. prot.: 24/23  
Datë: 14.09.2023

Mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitete jashtë shkollore,

IAAP "Lasgush Poradeci" në Kijevë shpallë:

**OFERT PËR EKSKURSION**

IAAP "Lasgush Poradeci" në Kijevë shpallë ftesë për oferta për zgjedhjen e agjencionit të udhëtimit për organizimin e Shëtijes (Eskursionit) në Republikën e Shqipërisë me maturantë për vitin shkollor 2023/24.

Kohëzgjatja e shëtijes (ekskursionit) do të jetë 4 netë/ 5 ditë, me pansion të plotë.


**Agjencioni duhet të plotësojë këto parakushte:**

1. Agjencioni duhet të jetë i licensuar;
2. Të ketë fletëdëshminë e kontrollës teknike të autobusëve sipas procedurave ligjore;
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevjat e nxënësve;
4. Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusëve.
5. Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe të ketë dëshmitë (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që i shoqëron nxënësit;
6. Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licensën) e akreditimit të ushqimeve në Shqipëri të vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit;
7. Kategorizimi do të bëhet në bazë të kriterëve dhe sigurisë, ku dhe do të vendoset për ofertën dhe vëndin e vëndosjes së nxënësve (hotelin), nga komisioni përkatës ditën e hapjes së ofertës.
8. Kontrata në mes të agjencionit dhe hotelit;
9. Agjencioni duhet të prezantojë menynë ditore për secilën ditë të qëndrimit në Shqipëri të nënshkruar dhe vërtetuar nga pronari i hotelit
10. Një fletëkonfirmim të rezervimit të hotelit përkatës të vërtetuar në mes të kompanisë dhe hotelit me datë të caktuar;
11. Licenca e ballos (vallëzimit) e vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit, ku nxënësit do të argëtohen;
12. Vertetimi i ATK-së
13. Hoteli ku bëhet akomodimi i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik dhe profesional;
14. Numri i nxënësve të vendosur nëpër dhoma,
15. Vendet kulturore-historike të cilat do të vizitohen
16. Agjencioni duhet ti mbulojë shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumente historike

**Ofertat të cilat nuk i përmbushin kriteret e kërkara nuk do të merren në shqyrtim.**

- Afati i aplikimit është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes, më 14.09.2023 (ditën e mërkurë).
- Ofertat pranohen në sportelin e DKA-së në Malishevë.
- Hapja e ofertave do të bëhet në ditën e fundit të aplikimit duke filluar nga ora 14:00, në shkollë.

Kijevë  
14.09.2023

 "Lasgush Poradeci", Kijevë  
*Zgjedhja*



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr.985/1

Datë: 18.09.2023

Në bazë të Ligjit nr. 04/l-032 Për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para universitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Udhëzimit Administrativ 05/2012, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Agjencia e AAAPARr-së, shpallë këtë:

## NJOFTIM

Njoftohen të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin e shpallur me nr. 972/1 të dt. 15.09.2023 për pozitën Drejtor i Qendrës të Kompetencës Ferizaj dhe dy pozita për Zëvendës Drejtor në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj,  
Se anulohet ky konkurs për arsye të një gabimi teknik.  
Shpallja e konkursit do të bëhet menjëher pasi të evitohet gabimi.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Afërdita Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH. M.M "Hysni Zajmi", Gjakovë.

- Simona Dodaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Jeton Nreca nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e viti të -I- të Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Albi Zeka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Neha Livoreka shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit "Laboutin By Culaccino Berlin" Hani Elezit.

- Kujtim Qela nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.M "Nexhmedin Nixha".

- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



